

SYLLABUS i Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|--|
| Njësia akademike: | Katedra Civilo-Juridike, Fakulteti Juridik |
| Titulli i lëndës: | E drejta e pronësis intelektuale |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | IV/ (semestri VIII) |
| Numri i orëve në javë: | 3+1 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 7 |
| Koha / lokacioni: | Prishtine |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Dr. Abdulla Aliu; Prof. dr. Haxhi Gashi |
| Detajet kontaktuese: | abdulla.aliu@uni-pr.edu ; haxhi.gashi@uni-pr.edu ; |
| Përshkrimi i lëndës | <p>E drejta e autorit është formë e pronësisë intelektuale. Ndikimi i teknologjisë në të drejtat e autorit është shumë i madh. Që nga lindja e saj me shpikjen e shtypit e deri te teknologjitë më të reja, e drejta e autorit është rritur dhe zgjeruar për të përfshirë vepra që ruhen në formate të reja.</p> <p>Ekzistojnë disa tensione në mes të legjislacionit dhe vendimeve të gjykatave se si trajtohen çështjet dixhitale dhe ekziston një konflikt i vazhdueshëm në mes të bartësve të të drejtave të autorit dhe përdoruesve të veprave dixhitale. Lënda e Drejta e Autorit do t'i trajtojë zhvillimet e reja teknologjike dhe si ato ndikojnë në të drejtat e autorit dhe po ashtu do të adresojë çështjet e balancimit të interesave në mes të autorëve/bartësve të të drejtave të autorëve dhe përdoruesve të veprave të autorit në kontekst vendor dhe ndërkombëtar.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimi i lëndës është ofrimi i njohurive në lidhje me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe instrumentet ndërkombëtare; identifikimi i koncepteve tradicionale të të drejtave të autorit dhe si kanë ndryshuar tani ato për shkak të zhvillimeve teknologjike; ekzaminimi dhe vlerësimi i zgjidhjeve aktuale dhe potenciale i konfliktit mes koncepteve tradicionale të të drejtës së autorit dhe koncepteve të reja; zhvillimi i shkathtësive analitike dhe komunikuese për ta lehtësuar aplikimin e ligjit në fushën e të drejtës së autorit.</p> |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë shkathtësi të qasjes kritike ndaj ligjit dhe arsyesimit ligjor në fushën e të drejtës së autorit. Praktika</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>gjqësore do të elaborohet po ashtu me studentët.</p> <p>Studentët do të inkurajohen përmes ligjeratave dhe ushtrimeve të zhvillojnë një qasje më kritike ndaj ligjit dhe vendimeve gjyqësore që zgjedhin çështje nga e drejta e autorit. Nga studentët do të kërkohet të punohen së paku dy punime mbi cilëndo çështje apo temë të diskutuar gjatë ligjeratave.</p> <p>Kjo përfaqëson një pjesë thelbësore dhe të obligueshme të punës. Punimet do të merren parasysh në notimin përfundimtar të studentit.</p> |
|--|--|

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|--|---------------|---------------|------------|
| Ligjërata | 3 | 1/15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 1/15 | 15 |
| Punë praktike | 1 | 1/15 | 15 |
| Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet | 1 | 1/15 | 15 |
| Ushtrime në teren | 4 | 1/4 | 16 |
| Kollokfiime,seminare | 2 | 2/2 | 4 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 1/13 | 26 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 1/15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 2 | 1/15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 4 | 1/1 | 4 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 10 | 1/1 | 10 |
| Totali | ECTS 7 | Totali | 210 |

| | |
|-------------------------------------|---|
| Metodologjia e mësimdhënies: | Ligjeratat do të jenë gërshetim i ligjërimit, diskutimeve, analizimit të rasteve hipotetike, debateve mbi temat/rastet që do të caktohen. Nga studentët kërkohet të jenë të përgatitur për orë mësimi meqë theksi në këtë lëndë do të vihet tek interpretimi ligjir dhe aplikimi i parimeve që burojnë nga materialet e caktuara për lexim. |
| Metodat e vlerësimit: | Prezantimet dhe puna në grup: 15 % Prezantimet individuale: 15 % Punimi seminarik: 20 % Provimi përfundimtar: 0-50% |

| Literatura | |
|------------------------------------|---|
| Literatura bazë: | <ul style="list-style-type: none"> • Abdulla Aliu, E drejta e Autorit, (ligjerata te autorizuar) Prishtine, Universiteti i Prishtines, Fakulteti Juridik • Paul Goldstein, Copyrights, New York, 1994. • Henneberg, I. Autorska Pravo, Zagreb, 2000 |
| Literatura shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> • Edelman, D. Droits d’auteur et droits voisins, Paris 1993. • Howell, H. The Copyright Law, Washington, 1948. • Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta • Konventa e Bernit mbi mbrojtjen e veprve artistike dhe letrare (1886) e miratuar në Bern. • Konventa e Brukselit (1974) |
| Plani i dizajnuar i mësimi: | |
| Java | <ul style="list-style-type: none"> • Ligjerata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | <ul style="list-style-type: none"> • Prezantim i syllabusit dhe rregullave • Hyrje në të drejtën e autorit • Historiku i të drejtës së autorit • Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta • Mekanizmat institucional për mbrojtjen e të drejtave të autorit |
| Java e dytë: | <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i të drejtës së autorit • Ndërlidhja mes të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta • Kushtet e mbrojtjes të të drejtave të autorit (originaliteti i veprës së autorit) • Veprat e prejardhura • Koleksionet e veprave • Krijimet pa mbrojtje |
| Java e tretë: | <ul style="list-style-type: none"> • Autori dhe Autorësia • Autori dhe bartësi i të drejtave të autorit • Supozimi i autorësisë • Bashkë-autorët • Autorët e veprave të gërshetuara |
| Java e katërt: | <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat morale (e drejta e publikimit të pare, e drejta e njohjes së autorësisë, e drejta e pendimit, e drejta e integritetit të veprës) • Të drejtat pasurore (e drejta e shfrytëzimit dhe format |

| | |
|------------------------|--|
| | <p>e saj)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i veprës në formën lëndore • Shfrytëzimi i veprës në formën jo lëndore • Shfrytëzimi i veprës në formën e ndryshuar |
| Java e pestë: | <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e tjera të autorit • E drejta e qasjes dhe ekspozimit • E drejta e në rishitje (droit de suit) • E drejta e huazimit publik • Pagesa e kompensimit të veçantë |
| Java e gjashtë: | <ul style="list-style-type: none"> • Kufizimet e së drejtës së autorit • Shfrytëzimi i lirshëm • Mësimdhënia • Riprodhimi privat dhe vetanak • Incizimet kalimtare • E drejta e informimit public • Citimet • Katalogët etj. |
| Java e shtatë | <ul style="list-style-type: none"> • Kohëzgjatja e të drejtës së autorit • Kufizimet e kohëzgjatjes të së drejtës së autorit • Kalimi i të drejtave të autorit • Marrëdhënia e të drejtës së autorit me të drejtën e pronësisë • Kontratat për të drejtat e autorit • Vëllimi i kalimit të të drejtave • Kalimi i mëtejme i të drejtave |
| Java e tetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Kontratat e veçanta të të drejtës së autorit • Kontratat e botimit • Kontratat e shfaqjes dhe kontratat e interpretimit • Kontratat e përpunimit të veprës • Kontratat e veprës kolektive të autorit |
| Java e nëntë: | <ul style="list-style-type: none"> • Dispozitat e veçanta për disa vepra të autorit • E drejta e përshtatjes audiovizuale • Bashkë-autorët e veprës audiovizuale • Kontrata e prodhimit të filmit • Të drejtat mbi fotografitë • Programet kompjuterike • Masat e veçanta të mbrojtjes |
| Java e dhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Veprat e autorit nga marrëdhënia e punës • Veprat e krijuara gjatë shkollimit • Te drejtat e përafërta me të drejtat e autorit • Të drejtat e interpretuesve • Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve • Të drejtat e producentëve të filmit • Të drejtat e shërbyesve medial audiovizual |

| | |
|--|---|
| Java e njëmbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhenave • Të drejtat e botuesve • Administrimi i të drejtave • Administrimi individual i të drejtave • Administrimit kolektiv i të drejtave • Shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave • Shpërndarja e të ardhurave • Ndërmjetësimi në fushën e të drejtave të autorit |
| <ul style="list-style-type: none"> • Java e dymbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e të drejtave të autorit • Personat që gëzojnë mbrojtje • Solidarësia e palëve • Mbrojtja e masave teknologjike • Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të autorit |
| Java e trembëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Masat për zbatimin e mbrojtjes • Mbrojtja e personave të huaj • Krahasimi i afateve të mbrojtjes • Mbrojtja doganore e pronësisë intelektuale |
| Java e katërbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Vështrim i përgjithshëm mbi të drejtën e autorit në Evropë • Ligji i BE-së në fushën e të drejtave të autorit • Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushën e të Drejtave të Autorit • Konventat Ndërkombëtare në fushën e të drejtave të autorit |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Permbledhje e lëndës. |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: | |
|--|--|
| <p>Nga studentët pritet të lexojnë materialin e caktuar për lexim para çdo ore dhe të jenë të përgatitur për të diskutuar rastet, çështjet dhe parimet. Nga studentët po ashtu pritet që të marrin pjesë në ligjerata dhe të jenë aktiv në diskutime gjatë këtyre ligjeratave. Gjatë provimeve, nga studentët kërkohet që ta prezantojnë ID-në dhe t'iu përmbahen rregullave dhe udhëzimeve. Shkelja e rregullave dhe parimeve etike do të ndëshkohen conform normave të parapara në Statut.</p> | |